



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

## BASHKIA MALIQ

### **RAPORT PËR MONITORIMIN E ZBATIMIT TË BUXHETIT TË 4 -Mujorit I-rë VITI 2019**

Në mbështetje të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 48, “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor”, Udhëzimit të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat Standarte të Monitorimit të Buxhetit të Njësisve të Vetëqeverisjes Vendore”, i paraqitim Grupit për Menaxhim dhe Strategji në Bashki “Raportin e monitorimit të zbatimit të buxhetit për 4-mujorin e I-rë të vitit 2019”.

Hartimi dhe zbatimi i buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2019 është bërë në mbështetje të akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi si më poshte:

- *Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”*
- *Ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar*
- *Ligjin nr.68 /2017“Për financat e vetëqeverisjes vendore”*
- *Ligjin nr. 9936 date 26.06.2008“ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.*
- *Ligjin nr 99/2018 dt 03.12.2018“ Për buxhetin e vitit 2019”.*
- *Udhëzimin e Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.9 datë 20.03.2018.“Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”*
- *Udhëzimin plotësues të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë nr.1 dt 17.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit2019”.*
- *Vendimi i Këshillit të Bashkisë nr 132 datë 14.12.2018 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Maliq për vitin 2019” dhe vendimin nr 24 datë 19.02.2019 “Për miratimin e buxhetit shtesë nga të ardhurat e mbartura nga viti 2018” si dhe vendimet e këshillit të marra për periudhën 4 mujore te vitit 2019, për ndryshime gjatë zbatimit të buxhetit.*

Raporti paraqet punën e administratës të Bashkisë Maliq dhe strukturave ndihmëse në zbatimin e politikave të përcaktuara nga Këshilli i Bashkisë si në realizimin e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore të Bashkisë, ashtu edhe në menaxhimin e shpenzimeve, për një rritje të cilësisë të shërbimeve të ofruara ndaj komunitetit.

Zbatimi i Buxhetit të Bashkisë Maliq për periudhën 4-mujore është realizuar duke zbatuar me korektësi ligjet, aktet nënligjore dhe vendimet e këshillit bashkiak për miratimin e tij dhe ndryshimet gjatë 4 mujorit të I-rë të vitit 2019.

### ***MISIONI I BASHKISË MALIQ***

Bazuar në ligjin 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, misioni i Bashkisë është sigurimi i një qeverisje të efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet ofrimit të shërbimeve të ndryshme, ushtrimit efektiv të funksioneve dhe kompetencave që ka bashkia duke realizuar shërbime

cilësore në përputhje me kërkesat që ka komuniteti, gjithashtu të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie.

### ***OBJEKTIVAT E BASHKISË MALIQ PËR VITIN 2019 janë:***

1. Zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik social, si në zonën urbane dhe atë rurale, me synim uljen e papunësisë, frenimin e largimit të fuqisë punëtore dhe rritjen e konkureshmërisë rajonale të Bashkisë Maliq.
2. Zhvillimi i mëtejshëm i infrastrukturës vendore dhe rajonale për të rritur e përmirësuar akset rrugore në boshket kryesore, duke përmirësuar shërbimet ndaj komunitetit dhe turizmit në zonat malore.
3. Mbështetja maksimale në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës dhe sportit me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të këtyre fushave prioritare.
4. Rritja e cilësisë të shërbimeve në të gjitha njësitë administrative, me qëllim përmirësimin e cilësisë së jetës të qytetarëve atje ku ata banojnë.
5. Rritja e transparencës dhe mirëpërdorimi i fondeve publike në dobi të komunitetit.

#### **Raporti i I-rë i monitorimit përmban :**

Aneksi nr.1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”;

Aneksi nr.2 “Raporti i shpenzimeve sipas artikujve buxhetorë”;

Aneksi nr.3 “Raporti i realizimit të produkteve të programit”;

Aneksi nr.4 “Raporti i realizimit të objektivave të programit”;

Aneksi nr.5 “Raporti i investimeve me financim të brëndshëm”;

“Pasqyra e treguesve financiarë”

#### **Buxheti i Bashkisë Maliq funksionon me 14 programe si me poshtë:**

1. 01110 Planifikim ,menaxhim dhe administrim
2. 01170 Gjendja civile
3. 03140 Sherbimet policore
4. 03280 Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri
5. 04220 Bujqësia
6. 04240 Menaxhimi infrastrukturës së Ujitje kullimit
7. 04260 Administrimi i pyjeve dhe kullotave
8. 04520 Rrjeti rrugor rural
9. 04980 Fondi rezervë dhe kontigjenca
10. 06260 Shërbimet publike vendore
11. 06330 Furnizimi me ujë
12. 08130 Sherbimet rekreative dhe sportive
13. 08220 Sherbimet kulturore
14. 09120 Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë
15. 09230 Arsimi i mesëm dhe i përgjithshëm

## 16. 10430 Ndhimja ekonomike dhe paaftësia

### Raporti i të ardhurave sipas zërave

Për 4 mujorin e parë të vitit 2019 plani i të ardhurave i miratuar nga Këshilli Bashkiak është 97 923 mijë lekë dhe realizimi 34 602 mijë lekë ose 35.3%. Në vlerë absolute për katërmujorin e parë të vitit 2019 kemi një mosrealizim kundrejt planit në shumën -63321 mijë lekë dhe ndaj faktit të vitit 2018 më pak -38398 mijë lekë .

Treguesit e mësipërm tregojnë për realizim në nivele të ulta të të ardhurave .Me gjithë punën e bërë nga kjo drejtori rezultati është jo i kënaqshëm.Në tabelën më poshtë po japim të ardhurat e planifikuara dhe realizuara sipas zërave dhe të ndarë në dy grupet tatimore dhe jo tatimore si dhe krahasuar me realizimin faktik të vitit 2018:

**Tabela e realizimit të të ardhurave sipas zërave për 4 mujorin e parë 2019**

Nr	Emërtimi	4 mujori I parë viti 2018			4 mujori I parë viti 2019			%
		Plan	Fakt	%	Plan 4-mujor	Fakt	%	
<b>I</b>	<b><i>Te ardhura tatimore</i></b>	-	-	-				
1	Taksë Ndërtese	7178	6872	96%	25%	11253	2829	25%
2	Taksë Trualli	1177	1012	86%	17%	2422	413	17%
7	Taksë Toke	24558	30400	124%	32%	22172	7000	32%
4	Taksë tabele	331	297	90%	51%	333	171	51%
5	Taksë Tregu	199	87	44%	55%	199	110	55%
6	Taksë Ndikimi në infrastrukturë	2822	6755	239%	146%	3000	4374	146%
7	Ndertime të reja	1333	0	0%	0%	1667	0	0%
8	Tatimi i thjeshtuar	333	800	240%	59%	500	294	59%
9	Regj. Automjeti në përd.	2850	3001	105%	118%	3333	3941	118%
10	T.Renta Minerale	183	0	0%	0%	183	0	0%
11	Të ardhura nga ZVRPP	13	101		0%	50	0	0%
12	Të Ardhura nga Qeraja	3809	2352	62%	99%	3833	3779	99%
13	Tatim mbi TAP	1867	0	0%	0%	1167	0	0%
14	Lejë për shitje me pakicë të karburanteve	6000	100	2%	30%	2000	600	30%
	<b>Shuma I</b>	<b>52653</b>	<b>51777</b>	<b>98%</b>	<b>45%</b>	<b>52112</b>	<b>23511</b>	<b>45%</b>
<b>II</b>	<b><i>Të ardhura jotatimore</i></b>	-	-	-				
1	Tarifë Pastrimi	19308	13876	72%	22%	29483	6535	22%
2	Tarifë Ndricimi	7980	4190	53%	19%	10083	1959	19%
3	Tarifë Gjelberimi	613	563	92%	25%	1720	432	25%
4	Regj. Autom. në Bashki	623	64	10%	91%	100	91	91%
5	Tarifë Parkimi	377	207	55%	73%	292	214	73%
6	Tarifa të ne Bashki	733	814	111%	91%	733	667	91%
7	Kullotat	0	0			0	0	
8	Te ardhura nga drute e Z.	0	0			0	0	
9	Mjete Korese	0	0			0	0	
10	Tarifë Uji per uitje	0	0			0	0	
11	<b>Tarife per mirembajtje kanale kulluese</b>	<b>334</b>	<b>230</b>	<b>69%</b>	<b>29%</b>	<b>772</b>	<b>225</b>	<b>29%</b>
	Familje 2019				<b>31%</b>	<b>520</b>	<b>159</b>	<b>31%</b>
	Familje 2018				<b>26%</b>	<b>252</b>	<b>66</b>	<b>26%</b>
12	<b>Tarife Mirm Varrezash</b>	<b>438</b>	<b>535</b>	<b>122%</b>	<b>31%</b>	<b>1984</b>	<b>606</b>	<b>31%</b>
13	Bileta spoti, Kulture, udhëtimi	50	0	0%	0%	50	0	0%

14	Tarifa Administrative	86	71	83%	59%	271	159	59%
15	Kazan Rakie	0	0			0	0	
16	Leja Non Stop	100	45	45%	50%	90	45	50%
17	Gjoha te	167	138	83%	68%	233	158	68%
18	Tarife per amortizim rruges	17	0	0%	0%	0	0	0%
19	Tarife per dhenie me qera te objekteve	50	0	0%	0%	0	0	0%
	Uji i pishem	0	490	0%	0%	0	0	0%
	<b>Shuma II</b>	<b>30876</b>	<b>21223</b>	<b>69%</b>	<b>24%</b>	<b>45811</b>	<b>11091</b>	<b>24%</b>
	<b>Shuma I+II</b>	<b>83529</b>	<b>73000</b>	<b>87%</b>	<b>35%</b>	<b>97923</b>	<b>34602</b>	<b>35%</b>

Siç shihet nga tabela

**Te ardhura tatimore**, për 4 mujorin e parë u realizuan në shumën **23 511 mijë leke**, ose 45 % të planit 2019 dhe 45.4 % ndaj faktit të vitit 2018. Në këtë grup të ardhurash, peshën kryesore e zë “Taksa e Pasurise” me një realizim të ardhurash rreth 10 242 mijë lekë, ose 28.6% ndaj planit, gjithashtu negativisht ka ndikuar dhe mosrealizimi i “Taksës për ndertimet e reja” me -1667 mijë lekë, por edhe zërat e tjera kanë ndikim negativ megjithse në % të vogël.

**Të ardhurat jo tatimore** për 4 mujorin e parë 2019 u realizuan në shumën **11 091 mijë lekë**, ose 24 % të planit 4-mujor ose 52.2% të realizimit faktik të 4-mujorit të parë të vitit 2018. Tarifat që kanë ndikim të madh në mosrealizimi i të ardhurave jo tatimore janë “Tarifa e pastrimit” e cila për 4 mujorin e parë 2019 u realizua në masën 22.2%, ose më pak -22948 mijë lekë, “Tarifa e ndriçimit” 1 959 mijë lekë ose 19 % e planit 4-mujor edhe tarifatat e tjera në % më të vogël.

Negativisht në realizimin i planit të të ardhurave ka ndikuar dhe pezullimi apo çregjistrimi i shumë subjekteve, të cilët janë parashikuar në planin e të ardhurave por realizimi është 0.

Në tabelë po japim si ka ndryshuar numri i bizneseve për tre vite 2017,2018 dhe 2019

	Viti 2017	Viti 2018	4 mujori I parë 2019
Subjekte aktivë	682	637	588
Pezulluar	68	82	41
Çregjistruar	56	34	101
Total	806	753	730

Siç shihet kemi një ulje të numrit të bizneseve në total prej 9.4% ose 76 subjekte më pak në krahasim me vitin fiskal 2017, ose 23 biznese më pak ndaj vitit 2018.

Drejtoria e të ardhurave po punon për saktësimin e bazës fiskale të taksapaguesëve dhe pasqyrimin e tyre në program. Duke analizuar treguesit e realizimit të planit të të ardhurave, bazuar dhe në ligjin 68 /2017 “Për financat vendore”, mendojmë të ndërmarim disa hapa për përmirësimin e treguesve fiskalë:

**Së pari:** bashkëbisedim dhe transparencë me komunitetin për tarifatat e dala nga drejtoritë në bashki, më parë se ato të futen në buxhet;

**Së dyti:** me të dhëna konkrete dhe bindëse do të propozojmë Kryetarit të Bashkisë në fund të 6-mujorit të parë të vitit 2019 të bëjmë një rishikim të buxhetit me qëllim hartimin e një buxheti real për tarifatat vendore, duke planifikuar familjet rezidente dhe bizneset aktivë, duke analizuar çdo lloj takse dhe tarife në bashki, duke parë se ku kemi rezerva dhe ku duhet të ulim planin;

**Së treti:** Mendojmë që për vitin 2020 mbledhjen e të ardhurave ta realizojmë me sh.a UK Maliq, kjo vjen për arsye se ka ardhur koha të mos dalim me taksambledhës në çdo shtëpi dhe biznes, por duke ja dhënë sha-së si agjent tatimor dhe ajo duke i mbledhur detyrimet nëpërmjet faturës të ujit. Nga informacioni që kemi në fund të fitit 2019 sha-ja do të ketë 10500 abonentë dhe bashkia do të realizojë të ardhurat për 10500 familje dhe biznese, nga 12000 familje rezidente, gjithashtu do të kemi arkëtime të sigurta për çdo muaj dhe rrjedhimisht barra fiskale është më e lehtë për familjarët dhe bizneset sepse do të shpërndahet në 12 muaj të vitit buxhetor.

**Së katërtri** : realizimi i planit të buxhetit është përgjegjësi e të gjithë strukturave në bashki,çdo drejtori të mbajë përgjegjësi për tarifrat e vendosura deri në realizim të tyre,çdo trafikë shërbimi do të shkojë në funksion të shërbimeve ku është llogaritur kostoja e shpenzimeve.

## **Raporti i shpenzimeve sipas programeve**

**Referuar ANEKSIT nr. 1 “Raporti i shpenzimeve sipas programeve”** për periudhën e 4 mujorit të parë të vitit 2019.

**Shpenzimet faktike në fund të 4 mujorit të parë të vitit 2019. janë realizuar në shumën 370,626 mijë lekë**,ose realizuar 74% ku ndikim më të madh në mos realizim ka programi 10430 “ Ndhim ekonomike dhe paaftësia”,që janë fonde të deleguara,por krahasuar me vitin 2018 realizimi 4 mujor është 92 %.Po të analizojme planin fillestar të buxhetit dhe planin e rishikuar gjatë 4 mujorit të parë janë bërë ndryshime me Vendim të Këshillit Bashkiak në tre programe kemi pakësim të fondit rezervë 04980 në shumën 570 mijë lekë duke shtuar programin 01110 me 570 mije për dhënie ndihma për raste fatkeqësie dhe emergjence.Gjithashtu kemi ndyshim në programin 06330 pakësim në vlerën 5,000 mije lekë duke kaluar në programin 04520 mirëmbajtje rrugë.

**Referuar ANEKSIT 2 “Raporti i shpenzimeve të programeve sipas artikujve”**, jep shpenzimet të grupuara sipas artikujve për të gjithë programet.

**1.Shpenzimeve korrente** janë realizuar në shumën 290,831 mijë lekë ose 74.3% po ta krahasojme me të njëjtën periudhë të vitit 2018 kemi 125.7 % ,ndikim më të madh kanë shpenzimet për mallra dhe shërbime si dhe transfertat për ndihmën ekonomike dhe paaftësinë.

Grupi i shpenzimeve kapitale është realizuar në shumën 79,795 mijë lekë ose 73.2%,krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018 është në masën 46.3 %.

Shpenzimet korrente në totalin e shpenzimeve si 4 mujor zënë 27.6 %,ndërsa shpenzimet për investime zënë 21.5%

### **Programi 01110 “ Planifikim ,menaxhim dhe administrim”**

#### **Objektivat:**

- 1.Zbatimi i politikave të përgjithshme për personelin;
- 2.Realizimi i shërbimeve të prokurimeve publike në kohë dhe me cilësi;
- 3.Realizimi i planit të të ardhurave nga taksat dhe tarifrat vendore;
- 4.Ndjekja dhe zbatimi i buxhetit vjetor,mirëmenaxhimi i fondeve publike dhe menaxhimi i të vendime këshilli ardhurave;
- 5.Ruajtja dhe mirëadministrimi i dokumentacionit dhe aseteve të Bashkisë;
- 6.Sigurimi i qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës të qytetarëve dhe punëve publike brenda territorit të Bashkisë si dhe ekzekutimi i akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe Këshilli Bashkiak;
- 7.Administrimi dhe mbrojtja e tokave bujqësore ,mbështetja e shërbimeve për blegtorinë,kontrolli ushqimor dhe mbrojtja e konsumatorit;
- 8.Planifikimi,zhvillimi dhe kontrolli mbi territorin.

Këto shpenzime janë planifikuar në funksion të realizimit të objektivave që ka Bashkia për këtë program ku futen shpenzimet për funksionimin e strukturave të Drejtorisë së Financës,Drejtorisë të të Ardhurave,DBNJÇL,DPKZHT,,IMT,Njësitë Administrative dhe strukturat mbështetëse të Kryetarit të Bashkisë.

***Referuar ANEKSIT të shpenzimeve në programi 01110 vihet re se shpenzimet në total krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2018, janë rritur në masën 55.9% ose + 26,785 mijë lekë dhe kjo vjen nga rritja e shpenzimeve në zërin e investimeve.  
Kundrejt planit progresiv shpenzimet janë realizuar në masën 93.4 % .***

## **Programi 03180 Shërbimet policore**

### **Objektivat:**

Të kryejë funksione në shërbim të rendit, qetësisë dhe mbarëvajtjes së jetës dhe punëve publike brenda territorit të bashkisë, në përputhje me dispozitat ligjore, kur ata nuk janë në kompetencë të ndonjë autoriteti tjetër shtetëror;Të realizojë zbatimin efektiv të akteve të nxjerra nga Kryetari i Bashkisë dhe vendimeve të Këshillit Bashkisë

Të marrë masat e duhura, duke bashkëpunuar edhe me seksionin e shërbimeve publike me qëllim zbatimin e funksioneve të bashkisë

Në vitin 2018 shpenzimet për këtë sektor ishin në programin 01110 për vitin 2019 është program më vete.

Numri i punonjësve në këtë sektor është 11 punonjes,shpënzimet për 4 mujorin e parë janë realizuar në shumën 2390 mijë lekë ose 66% e planit.

## **Programi 10910 “Shërbimet e mbrojtjes nga zjarri”**

### **Objektivat:**

1.Organizimi kësaj strukture për garantimin e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi për komunitetin,blegtorinë,ndërtesat,pyjet dhe kullotat, për parandalimin,mbrojtjen nga zjarri dhe përballimin e emergjencave të tjera që vijnë nga fenomene të natyrës apo nga veprimtari njerëzore.

### ***Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 10910 ,***

Sektori i MZSH është krijuar gjatë vitit 2018, ne katërmujorin e dytë me fonde specifike,numri i punonjësve të planifikuar është 14 punonjës.

Shpenzimet janë realizuar në shumën 7,022 mijë lekë ose 42.5% të planit .

## **04220 “ Bujqësia ”**

### **Objektivat:**

- Ngritja, plotësimi, ruajtja dhe përditësimi i një sistemi informacioni mbi bazë parcele për tokën bujqësore, që të përmbajë informacion për vendndodhjen e saktë, përmasat dhe pronësinë e parcelave
- Prodhimi dhe përhapja e informacionit të përgjithshëm, dokumentacionit teknik dhe statistikave për çështjet dhe shërbimet bujqësore

Organizim ose mbështetje e shërbimeve veterinarë për blegtorinë.

Në vitin 2018 shpenzimet për këtë sektor ishin në programin 01110 për vitin 2019 është program më vete.

Numri i punonjësve në këtë sektor është 12 punonjes,shpënzimet për 4 mujorin e parë janë realizuar në shumën 2564 mijë lekë ose 69.7 % i planit.

**04240**      *“Menaxhimi infrastrukturës së ujitje kullimit”*

**Objektivat:**

- 1.Organizimi i punës për shrytëzimin dhe mirëmbajtjen e infrastrukturës së ujitje kullimit me qëllim rritjen e produkteve bujqësore.
- 2.Organizimi i sistemit të kontrollit të përmbytjeve.

*Referuar ANEKSIT të shpenzimeve për programin 04240,*

*Ky program funksionon me 40 punonjës plani i shpenzimeve 4 mujore është realizuar në masën 41.2% .*

*Mosrealizim kemi në shërbimet operative dhe investimet për arsye se kontratat janë në proces likuidimi.*

**04260**      *“Programi pyje e kullota”*

**Objektivat:**

- 1.Administrimi i fondit pyjor dhe kullor ,shfrytëzimi në mënyrë racionale i pyjeve dhe kullotave.
- 2.Organizimi dhe marrja e masave për vënien nën kontroll të sëmundjeve dhe dëmtuesve në pyje dhe parandalimin e zjarreve dhe fenomeneve të pa dëshirueshme në pyje.

*Ky program funksionon me 26 punonjës plani i shpenzimeve 4 mujore është realizuar në masën 69.6% .Krahasuar me vitin 2018 ka një rritje me 8.4%*

*Mosrealizim kemi në shërbimet operative dhe investimet për arsye se kontratat janë në proces likuidimi.*

**04520**      **Rjeti rrugor rural**

**Objektivat :**

- 1.Ndërtimi dhe mirëmbajtja e infrastrukturës rrugore urbane dhe rurale si rrugë,ura ,sheshe publike ,trotuare ,vepra arti në të gjithë njesitë administrative të Bashkisë Maliq,me qëllim realizimin e lehtësimit të trafikut të mjeteve dhe lëvizjen e lirëshme të qytetarëve.

*Ky program funksionon me 27 punonjës plani i shpenzimeve 4 mujore është realizuar në masën 68.5% .Krahasuar me vitin 2018 ka një rritje me 474% sepse në vitin 2019 kemi bashkuar dhe programin 04530*

**06260**      **Sherbimet publike vendore**

**Objektivat:**

- 1.Kryerja e shërbimit të pastrimit dhe largimit të mbetjeve urbane të 6 njesive administrative .
- 2.Mirëmbajtja e të gjithë institucioneve arsimore dhe administrative në 75 shkolla dhe kopshte me qëllim krijimin e kushteve sa më të mira për nxënësit dhe rritjen e cilësisë të mësimdhënies.
- 3.Mirëmbajtja e sipërfaqeve të gjelbërta,trotuareve, varrezave në të gjithë territorin e bashkisë me qëllim rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj komunitetit.
- 4.Zgjerimi i rrjetit të ndricimit dhe mirembajtja e rrjetit ekzistues.

***Ky program funksionon me 144 punonjës plani i shpenzimeve 4 mujore eshte realizuar në masën 95.3% .Krahasuar me vitin 2018 ka nje rritje me 41 %***

#### **06330 Ujësjellës kanalizime**

##### **Objektivat :**

1.Sigurimi i furnizimit me ujë të popullsisë të Bashkisë Maliq duke rritur cilësinë e ujit dhe orët e furnizimit nëpërmjet investimeve në ujësjellsa të rinj dhe kanalizime.

***Plani i shpenzimeve 4 mujore eshte realizuar në masën 98% .Krahasuar me vitin 2018 ka një rritje me 16 %.***

***Shpenzimet e planifikuara në këtë program jane investime që kryen Bashkia për ujësjellsa dhe KUZ .Keto jane politikat e bashkisë në drejtim të shërbimeve ndaj komunitetit për të përmirësuar furnizimin me ujë pijshëm të Komunitetit dhe menaxhimin e ujrave të zeza.***

#### **08130,08220 Sporti dhe kultura**

##### **Objektivat:**

- 1.Mbrojtja dhe promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore;
- 2.Organizimi i eventeve kulturore për të pasur një jetë artistike të larmishme gjatë gjithë vitit duke dhënë koncerte,filma dhe shfaqje artistike;
- 3.Mbrojtja dhe promovimi i bibliotekave i ambienteve për lexim në te gjithë njesitë Administrative për të rritur numrin e lexuesve nga të gjitha moshat;
- 4.Mbështetje dhe funksionimi i ambienteve sportive,mbështetje ekipit përfaqësues të bashkisë si dhe ekipeve zinxhir me qëllim masivizimin e sportit, duke i orientuar nxënësit e shkollave drejt sportit dhe aktiviteteve kulturore.

***Këto programe funksionojnë me 19 punonjës plani i shpenzimeve 4 mujore eshte realizuar në masën 65.8% .Krahasuar me vitin 2018 ka nje ,ritje me 45.5%***

***Mosrealizim kemi ne shërbimet operative dhe investimet ,për arsye se kontratat janë në proces likuidimi.***

#### **Programi 09120 “Arsimi parashkollor dhe arsimi bazë”**

Ky program zbatohet me fonde specifike , për pagat dhe sigurimet shoqërore,numri i punonjësve arsimorë dhe mbështetës i planifikuar në fillim të vitit ishte 94 dhe realizuar 94 punonjës. Përveç fondeve specifike për këtë pogram Bashkia ka planifikuar nga fondet e veta për shpenzime operative për mirembajtje dhe shpenzime për investime kapitale.

***Plani i shpenzimeve 4 mujore është realizuar në masën 27 186 mijë lekë ose 75.2% .Krsahasuar me 4 mujorin e viti 2018 duket nje mos realizim i zërit investime kjo për arsye se në këtë periudhë është bërë investimi në dy shkolla të mesme.***

#### **Programi 09230 “Arsimi i mesëm dhe i përgjithshëm”**



Ky program zbatohet me fonde specifike , për pagat dhe sigurimet shoqërore,numri i punonjësve arsimorë dhe mbështetës i planifikuar në fillim të vitit ishte 16 dhe realizuar 16 punonjës. Përveç fondeve specifike për këtë pogram Bashkia ka planifikuar nga fondet e veta për shpenzime operative për mirembajtje dhe shpenzime për investime kapitale.

*Plani i shpenzimeve 4 mujore është realizuar në masën 4,176 mijë lekë ose 75.7% .Krsahasuar me 4 mujorin e viti 2018 kemi një rritje prej 45%.*

**10430 “Programi për ndihma ekonomike dhe paaftësinë” ,**

Janë programe që përballohen me fonde të deleguara nga buxheti i shtetit,planifikimi i fondeve bëhet nga ministritë përkatëse dhe realizimi është në përputhje me planin, *plani i shpenzimeve 4 mujore është realizuar në masën 121888 mijë lekë ose 62.1% .Krahasuar me 4 mujorin e viti 2018 kemi një rritje prej 18.6%.*

### **ANEKSI 3**

**Referuar aneksit 3 “Raporti përmbledhës i realizimit të treguesve të performancës të produkteve të programit”**

Ne lidhje me Aneksin 3 jane plotësuar të gjitha tabelat sipas programeve por kostoja nuk del reale sepse nuk jane mbyllur të gjitha shpenzimet për sherbimet,mallrat etj .

### **ANEKSI 4**

**“Raporti i realizimit të objektivave të politikës të programit”**

**Për plotësimin e këtij Aneksi po punojmë për të vendosur tregues performance sa më realiste dhe jemi duke punuar me projektin “Bashki të Forta”.**

**ANEKSI 5** paraqet realizimin e investimeve me financim të brendshëm ,për 4 mujorin e parë janë investimet e kryera në vitin 2018 dhe janë likujdur në vitin 2019,për investimet e vitit 2019 jemi në procedurë prokurimi dhe zbatimi të kontratës.

**Treguesit Financiarë janë sipas tablës bashkangjitur .**

**Faleminderit!**

**KRYETARI I BASHKISË**

**GËZIM TOPÇIU**

---